

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER
AKTIVITETIN:
"SHFRYTEZIM GURI GELQEROR"**

Vendodhja: Objekti "Kodra e Konisbaltes,
Prane Fshatit Konizbalte, Bashkia Ura
Vajgurore, Berat.

Kërkues:Subjekti:"ARDMIR" sh.p.k

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENTS CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu



Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Nentor, 2018

1.1. Hyrje

Shoqeria " ARDMIR" sh.p.k. eshte titullar i lejes minerare te tipit te dyte per shfrytezimin e mineraleve te grupit te katert me Nr.1577 me date 07.09.2012 te dhene nga Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes me afat 25 vjecare dhe me rinovim vjetor te saj, per shfrytezimin e gurit ge1qeror .

Shoqeria ka punuar sipas programit te miratuar nga drejtoria minerare prane AKBN

Materiali qe do te prodhohet nga hapja ketij objekti ka si qellim prodhimin e shfrytezimit te gurit gelqeror duke zbatuar programin e miratuar edhe projektin eshfrytezimit duhet hapur rruge ku do te dali nje sari guri ge1qeror nga hapja e rrugeve hyrese dhe qarkullimit brenda karrieres..

Sheshi i perzjedhur nga shoqeria per tu shfrytezuar ndodhet ne te djathte te rruges se makines Konizbalte — Ura Vajgurore ne nje distance rreth 200 m larg ne vije ajrore.

Sheshi i perzjedhur nga shoqeria per tu shfrytezuar ndodhet ne te djathte te rruges se makines Konizbalte — Ura Vajgurore ne nje distance rreth 200 m larg ne vije ajrore.

Fshati konizbalte ndodhet ne Jug te zones ne fjale ne nje distance ne nje vije ajrore rreth 700 m larg . Zona e lejes ben pjese ne hartat tpografike ne shkalle 1 :25000 me moniklature K-34- 112-D-a (Poshnja)

1.2. Ndertimi Gjeologjik i Vendburimit

Ne ndertimin gjeologjik te objektit te miratuar per shfrytezimin marrin pjese depozitimet karbonatike material i shkaterruar te perfaqesuar nga copra te gelqeroreve te Kretakut te siperm (Cr2) te cilat kane nje orintim shtrirje dhe renie si e gjithe struktura Konizbaltes

Ne pergjithesi keto depozitime jane te shkaterruar te ripodepozituara me nje cimentim shume te dobet dhe si lende cimentuese sherben lenda karbonatike e tretur.Gjate shfrytezimit te kryer verehen copra te madhesive nga 2- 5 cm deri 1m

Vende Vende gelqeroret jane ne copra mesatare dhe rralle ne madhesi deri 1m dhe jane te eroduar nga agjentet atmosferike ku vepron fuqishem edhe fenomeni i karstit i cili krijon zgavra, gropa e hinka te mbushura me material argjilor (toka te kuqe)

Keto gelqerore jane me strukture mikrokorrizore me ngjyre bezhe te celur vende vende organogjene te , Jane kompakte ku ne brendesi dallohen edhe mikrocarje te mbushura me material kaciti..

Gjate goditjeve ne thyerje paraqiten me nje thyerje spicore dhe nje tingellim te kthjellat.

Ne pjesen masive te gelqeroreve vihet re procesi i dolomitizimit qe eshte zhvilluar pas litifikimit te vete masivit shkembor gelqeror dhe lidhet me qarkullimin e ujrave te infiltracionit me perberje magneziale.


Nga pikpamja strukturale objekti eshte vazhdim i strukturave antiklinale te varg malit Kruje Dajt dhe ndodhet ne Perendim te kesaj strukture.

Ne prerjet erezionale duket qarte qe coprat e shkembinjve jane me shtrirje verilindje-JugPerendim me renie Perendimore me azimuth renie rreth 39-42 grade , dhe me nje kend renie 35 grade.

MAGAZINIMI DHE TREGTIMI I NAFTES

Nga te dhenat e mesiperme te matura ne harten topografike te shkalles se detajuar rezulton se siperfaqia qe kerkohet te shfrytëzohet eshte **0.1km²**

NR	X	Y
1	45 15 000	44 04 200
2	45 15 000	44 04 630
3	45 14 620	44 04 500
4	45 14 825	44 04 225
5	45 14 845	44 04 240
6	45 14 910	44 04 268
7	45 14 915	44 04 245
8	45 14 938	44 04 250
9	45 14 948	44 04 225
10	45 14 960	44 04 230
11	45 14 962	44 04 215
12	45 14 980	44 04 200



1.2.1. Treguesit kimik dhe fiziko mekanike te gelqeroreve te objektit

Per te gjykuar mbi fushen e perdrimit te produkteve dhe nenprodukteve e prodhuar nga shfrytezimi i gurit gelqeror, ne objekt u moren mostra dhe u bene analizat perkatese kimike , fiziko-mekanike dhe te polerimit te gurit gelqeror .

Nga analizat e kryera rezultoi :

- Perberja kimike e gelqeroreve te analizuar ne kete vendburim eshte si vijon .

Treguesit cilesore te gelqerorit te objektit

CaO	Fe ₂ O ₃	MgO	Al ₂ O ₃	SiO ₂	HK
52.92	1.65%	2.65%	0.29	7.82	41.46
%				%	%

- Analizat fiziko mekanike te kampineve te studjuara tregojne se keta gelqerore kane karakteristikat e meposhteme :
 - Rezistenca ne shtypje ne gjendje natyrale e kampione te analizuar, rezulton nga 1020 kg/cm² ne 1150 kg/cm².

Per realizimin e ketij volumi nuk eshte perdorur lende eksplozive pasi materiali eshte shkaterruar dhe nuk ka patur nevojte por vetem me forcen mekanike te koves se eskavatorit.

1.2.2. Programi ekonomik-financiar dhe teknik per periudhen 07.09.2017 deri 07.09.2018 detajuar ne 3 mujore

Per kete periudhe, aktiviteti i metejshe i firmes do te jete vazhdimi i prodhimit te gurit gelqeror sipas kapacitetit te parshikuar ne projekt program prej 100 000 m³

Guri gelqeror qe do te prodhohen nga karriera do te perdoret per prodhimin e materialit inert te klasave te ndryshme per perdorim ne industrine e ndertimit dhe shtrimin e rrugeve (autostradave) te shfrytezimit nenproduktet e prodhuar do te shiten ne treg per perdorim ne ndertime dhe desitacione te tjera ne perputhje me kerkesat e tregut

Prodhimi i gurit gelqeror qe parashikohet te realizohet per kete periudhe do te jete reth 100 000 ml



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENSIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DREJTORIA MINERARE

Nr. _____ Prot. _____

Tiranë, më / / 05/ 2018

Lënda:

**MIRATIMI I PROGRAMIT VJETOR
PËR PERIUDHËN 07.09.2018 deri 07.09.2019**

"Admir" Sh.p.k
Z. Fatmir ÇOBO
Ura Vajgurore, Qarka Berat

Grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr.8 datë 16.01.2018, të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-s "Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit të planit vjetor të punës nga zotëruesit e lejeve minerare", i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe të VKM nr. 232, datë 23/03/2011 "Për Miratimin e Funksioneve të Strukturave Përgjegjëse në Sektorin Minerar të Republikës së Shqipërisë", pasi rishqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga ana Juaj, vendosi:

Miratimin e Programit Vjetor të Punës, për Lejen Minerare Nr. 1577 datë 07.09.2012, Objekti: "Kodra e Konizbales", Ura Vajgurore, Berat për shfrytëzimin e mineralit Gur Gëlqeror, për periudhën 07.09.2018 deri më datë 07.09.2019.

Ju bëjmë me dije, se zbatimi i programit vjetor të punës për periudhën 07.09.2018 deri 07.09.2019, nga ana e shoqërisë Tuaj, do të jetë objekt i kontrollit të vazhdueshëm nga strukturat tona të specializuara.

Në zbatim të nenit 18 pika 1/ç, 25/ç dhe 27 pika 2/e të ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", subjekti i licencuar ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin për raportimin e aktivitetit të kryer gjatë periudhës 07.09.2018 deri 07.09.2019, për shqyrtim në AKBN jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi e lejes minerare, pra në datën 07/08/2019.

Në rast të mosrespektimit të këtij afati në zbatim të nenit 45, pika 1, shkronja dh) e ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", shoqëria Juaj do të gjobet me një shumë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Mosrespektimi i këtij afati për herë të dytë, dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin e detyrimit ligjor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORI EKZEKUTIV

ADRIAN BYLYKU



2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1. Te pergjithshme mbi aktivitetin

Shoqeria " ARDMIR" sh.p.k. eshte titullar i lejes minerare te tipit te dyte per shfrytezimin e mineraleve te grupit te katert me Nr.1577 me date 07.09.2012 te dhene nga Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes me afat 25 vjecare dhe me rinovim vjetor te saj, per shfrytezimin e gurit gelqeror .

Shoqeria ka punuar sipas programit te miratuar nga drejtoria minerare prane AKBN

Materiali qe do te prodhohet nga hapja ketij objekti ka si qellim prodhimin e shfrytezimit te gurit gelqeror duke zbatuar programin e miratuar edhe projektin e shfrytezimit duke hapur rruge ku do te dali guri gelqeror nga hapja e rrugëve hyrese dhe qarkullimit brenda karrieres.

Veprimtaria minerare e shfrytezimit per realizimin e programit te investimit, sipas projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare te shfrytezimit do te permbaje keto operacione pune ;

Hapja e vendburimit rruge, sheshe, sistemime, makineri e pajisje

- Rezerva gjeologjike te nxjerreshme (sasi dhe cilesi) jane 2 641 000 m³ me permbajtje 52.92% CaO.
- Rezerva gjeologjike (sasi dhe cilesi) jane 3 558 000 m³ me permbajtje 52.92 % Ca°
- Prodhim minerali ne total 2 200 000 m³ permbajtje 52.92 % CaO.
- Prodhim minerali ne vit 100 000 m³ permbajtje 52.92 % CaO.
- Fuqia punetore per realizimin e projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare te shfrytezimit do te jete 12 (dymbedhete) punonjes.

2.2. Mënyra e shfrytëzimit

2.2.1. Përzgjedhja e sistemit të shfrytëzimit të objektit

Për të përcaktuar mënyrën e shfrytëzimit u morën në konsideratë këta elementë:

- topografia e zonës së projektit,
- sasia e rezervave të shfrytëzueshme,
- karakteristikat gjeomekanike të shkëmbinjve,
- elementët e shtruarjes dhe koeficienti i zbulimit.

Nga analiza e këtyre faktorëve është përzgjedhur si më i përshtatshëm shfrytëzimi me qiell të hapur i objektit.

Gjithashtu, shfrytëzimi me karrierë i gurit gëlqeror në objektin favorizohet dhe nga:

- Rënia e formacioneve që ndërtojnë pakon produktive, në drejtim të tillë që lejojnë zhvillimin normal të shkallëve dhe elemeteve të tyre pa sjellë kushtëzime teknike.
- Eksperienca e shfrytëzimit në objekte të njëjta, e cila ka treguar se elementët e shtruarjes së formacioneve të gurit gëlqeror dhe karakteristikat gjeomekanike të tyre favorizojnë këndet deri 75° të skarpave dhe nuk sjellin asnjë rrezik rrëshqitje.
- Hidrografia e zonës në përgjithësi dhe territori i projektuar për lejen minerare në veçanti. Sipërfaqja është plotësisht e drenuar dhe nuk ka probleme ujërash dhe burimesh të pranishme në të, për rrjedhojë nuk pritet të krijojë probleme për shfrytëzimin e vendburimit.

- Koeficienti i zbulimit në masën e pakonsiderueshme, në sajë të të cilit nuk ka nevojë për sipërfaqe të depozitimit të përhershëm ose të përkohshëm të sterileve. Për pasojë, i gjithë aktiviteti do të kryhet në kufijtë e lejes minerare dhe nuk do të ketë kërkesa për shtesë sipërfaqe ose ndryshim kufijsh të sipërfaqes së lejes.

2.2.2. Kapaciteti Prodhues

Prodhimi i gurit gëlqeror nga shfrytëzimi i objektit Konisbalte do të ketë si destinacion përdorimin si material inert në fushen e ndertimit. Në varësi të volumit të parashikuar të punimeve për këtë projekt, subjekti parashikon një prodhim vjetor prej rreth 100,000 m³/vit .

Veprimtaria minerare e shfrytëzimit gjate gjithe periudhes fillestare te lejes minerare sipas projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare do te realizoje:

Prodhim gelqerori ne total 2 200 000 m³
 Prodhim minerali ne vit 100 000 m³

2.2.3. Drejtimi I Shfrytëzimit

Drejtimi i pergjithshem i shfrytëzimit do te vazhdoje te jete i kombinuar nga lart poshte , nga poshte lart dhe nga qendra per ne kufi ne shkallen e pershkruara me siper te harmonizuara me njera tjetren per kryerjen e transportit te brendshme si dhe ngarkimit dhe transportit te materialit te prodhuar per to cuar, sipas kerkesave dhe programit te parshikuar te zhvillimit te punimve te shfrytëzimit, ku do te shitet produkti i prodhuar .

Ne tabelen e meposhteme jepet realizimi i pritshem i prodhimit te gurit gelqeror (brekcie te shpatit) i ndare ne 3 mujore ne shkalle, ne zonen midis profileve I-I ,II-II dhe III-III .

Ne profilet perkatese, te permendura me siper dhe ne planimetri jane pasqyruar levizj et e parashikuara ne shkalle per realizimin e prodhimit per periudhen ne vazhdim


Parashikimi I prodhimit ne tremujore ne shkalle

Nr	Shkalla	Tremujoret				Viti
		I	II	III	IV	
	Prodhim m ³	10000	40000	40000	10000	1000

2.3. Vendodhja e aktivitetit

Sheshi i perzjedhur nga shoqeria per tu shfrytezuar ndodhet ne te djathte te rruges se makines Konizbalte — Ura Vajgurore ne nje distance rreth 200 m larg ne vije ajrore.

Fshati konizbalte ndodhet ne Jug te zones ne fjale ne nje distance ne nje vije ajrore rreth 700 m larg. Zona e lejes ben pjese ne hartat topografike ne shkalle 1 :25000 me moniklature K-34- 112-D-a (Poshnja)



3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE

3.1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë fazës së shfrytëzimit

Në këtë paragraf është realizuar një përmbledhje cilësore e ndikimeve të mundshme në mjedis të veprimtarisë së propozuar. Referuar tabelave së mësipërme, të gjitha ndikimet, janë vlerësuar në kategorinë mesatare dhe të ulët, dhe kryesisht të kthyeshme, që tregojnë se shkalla e ndikimit në vlerat e mjedisit të zonës është e kufizuar. Plani i Menaxhimit të Mjedisit përmban masat parandaluese dhe kompensuese për çdo ndikim të mundshëm të identifikuar dhe të analizuar në këtë seksion.

- Ndikimi më i rëndësishëm që rrjedh nga zbatimi i projektit është ndryshimi i destinacionit të përdorimit të tokës. Sipërfaqja e përgjithshme e kërkuar për shfrytëzim është 0.098 km² por bazuar në projektin teknik, referuar dhe jetëgjatësisë së karrierës, do të shfrytëzohet sipërfaqe me e vogël.
- Po kaq është edhe sipërfaqja e tokës e cila parashikohet të dëmtohet nga ana strukturore si pasojë e zbatimit të projektit. Vlen të theksohet se ndonëse kjo sipërfaqe rezulton sipërfaqe pyjore, ajo është pjesërisht e zhveshur në rreth 50% të saj, për rrjedhojë jo produktive.
- Bazuar në Raportin Teknik, gjatë hapjes dhe shfrytëzimit të karrierës do të realizohet një volum i përgjithshëm gërmimi prej 2 200 000 m³. Njëkohësisht është treguar se për shkak të ndërtimit gjeologjik, erozionit dhe mungesës së vegetacionit në pjesën më të madhe të sipërfaqes së objektit, mungon shtresa vegetale dhe për rrjedhojë sasia e sterileve do të jetë e papërfillshme.
- Gjithashtu si rezultat i aktivitetit të propozuar do të ndodhë shqetësim i shtresës së tokës dhe dëmtim i strukturës së saj në sipërfaqen e shfrytëzimit. Ndikimi në cilësitë agronomike të tokës do të dëmtojë potencialin e saj për mbirjen e bimësisë dhe për këtë arsye do të nevojiten masa rigjeneruese gjatë zbatimit të projektit.
- Për shkak të përbërjes dhe morfologjisë zona minerare është e ekspozuar ndaj erozionit. Aktiviteti që propozohet të zhvillohet në të, mund të shkaktojë rritje të shkallës së erozionit. Erozioni dhe lëvizja e grimcave shkëmbore jashtë objektit, që do të thotë ushtrimi i ndikimit të tyre jashtë kufijve të objektit. Pjerrësia e terrenit bëhet shkak që grimcat e tokës të ekspozohen ndaj agjentëve atmosferikë duke u shkëputur dhe lëvizur jashtë zonës së shfrytëzimit. Erozioni do të kontrollohet përmes masave të parashkuara në Planin e Menaxhimit.
- Një tjetër ndikim i mundshëm është humbje e pjerrësisë së tokës në skarpitetet e shkallëve të karrierës. Sipërfaqja tjetër e mbetur nga shfrytëzimi do të jetë horizontale dhe pas rehabilitimit do të ketë kushte të mira.
- Së fundmi, si pasojë e përdorimit të mekanikës dhe makinerive në presion hidraulik mund të shkaktojë ndotje të tokës me lubrifikante dhe lëndë ndotëse.
- Duke qenë se të gjitha mjetet dhe makineritë që do të përdoren në karrierë janë me motor me djegie të brendshme, cilësia e ajrit ka të ngjarë të ndikohet si pasojë e shkarkimeve në mjedis të gazeve të djegies NOx dhe SOx, por ndotja e ajrit do të jetë e shpërndarë dhe e pakonsiderueshme. Kjo ndotje nuk do të dëmtojë cilësinë e ajrit në zonën e projektit dhe jashtë saj. Nga ana tjetër vetë natyra e aktivitetit të propozuar dhe mënyra e zgjedhur për shfrytëzim, janë shkak i gjenerimit të zhurmave dhe një sasive pluhuri, i cili do të jetë më i ndjeshëm në stinën e thatë. Gjithsesi për shkak të pozicionit të fshatit përkundrejt faqes së shfrytëzimit, zhurma dhe pluhuri nuk do të përbëjnë problem për komunitetet e zonës. Po kështu as vibrimet e mundshme. Me zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit do të parandalohen edhe ndikimet në shëndetin e punëtorëve.
- Zhvillimi i aktivitetit të propozuar mund të shoqërohet edhe me ndikime në ujërat sipërfaqësorë të zonës, ndonëse ata rrjedhin të distancuar prej saj. Nëse sasirat e dheut të gjeneruara si rezultat i

gërmimeve, nuk sistemohen në mënyrën e duhur, grimcat e tokës nën veprimin e agjentëve atmosferikë mund të lëvizin drejt trupave ujorë të zonës duke shkaktuar ndotje të tyre.

- Njëkohësisht avaritë e mekanikës mund të bëhen shkak për rrjedhje lubrifikantësh dhe karburantësh, të cilët nën veprimin e ujrave të shiut mund të shkaktojnë ndotje të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.
- Gjithashtu veprimtaria mund të shoqërohet me ndikim të botës së gjallë. Nëse ndikimet e evidentuara deri tani janë të njëjta për të dy fazat e zhvillimit të aktivitetit, ndikimet në botën e gjallë dallohen. Në fazën e zbulimit ndikimet mund të shfaqen si në florë ashtu edhe në faunë. Punimet e zbulimit kërkojnë pastrimin e sipërfaqes nga vegetacioni. Zona, edhe për vetë ndërtimin gjeologjik është e varfër në bimësi, kështuqë vegetacioni që do të pritet dhe hiqet është kryesisht i ulët i tipit të shkurreve. Njëkohësisht mund të ndodhë dëmtim habitati dhe folesh të llojeve biologjike si dhe largim i faunës nga zona e projektit dhe përreth saj për shkak të zhurmës dhe pluhurit. Ndërsa faza e shfrytëzimit karakterizohet vetëm nga ndikimet në faunë, të cilat janë kryesisht mbajtja larg e faunës për shkak të zhurmave, pluhurit dhe vibrimeve. Këto ndikime janë të pashmangshme por masat për zbutjen e tyre mund të rezultojnë të sukseseshme në fazat e ndryshme të zhvillimit të biodiversitetit, veçanërisht gjatë ciklit të riprodhimit. Këto masa do të mund të zbatohen me më tepër efikasitet gjatë vitit të dytë të shfrytëzimit mbasi të jetë njohur mirë sjellja e biodiversitetit në objekt.
- Ndër ndikimet më evidente do të jenë ndryshimet në pjerrësinë e terrenit dhe ato vizuale të pejsazhit. Gjithashtu ndikime do të ketë edhe në zhvillimin e proceseve të tokëformimit etj. në sipërfaqen e prekur.
- Gjenerim i mbetjeve urbane nga aktiviteti njerëzor: kartona, bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjësve.
- Aksidente të mundshme të punonjësve gjatë proceseve teknologjike në objekt, veçanërisht gjatë kryerjes së shpërthimeve.

Mënjanimi i këtyre rreziqeve varet shumë nga masat që do të parashikohen dhe zbatohen në Planin e Menaxhimit.

4. MASAT E PROPOZUARA PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të gjithë punonjësit janë të detyruar të zbatojnë një Kod sjelljeje i cili siguron pajtueshmërinë e aktivitetit të tyre me Planin e Menaxhimit të Mjedisit. Përveç udhëzimeve të përgjithshme të gjithë punonjësit duhet të trajnohen dhe marrin udhëzime të veçanta në përputhje me funksionet e secilit në projekt përpara se ata të nisin punën në terren. Punonjësit nuk duhet të fillojnë punë në rast se nuk kanë marrë udhëzimet përkatëse për punën që do të kryejnë lidhur me:

- Gjendjen ekzistuese të mjedisit;
- Ndikimet e mundshme në zonën e projektit;
- Masat për zbutjen e ndikimeve dhe eliminimin e tyre;
- Planin e Menaxhimit të Mjedisit;
- Menaxhimin e mbetjeve;
- Politikat e mbrojtjes së mjedisit;
- Planin e përgjigjes ndaj emergjencave dhe rreziqeve;
- Sigurinë e shëndetin në punë.

4.1. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit në zonën e lejuar minerare të shfrytëzimit duhet të respektojë këto kondita specifike:

- Të njohë dhe të zbatojë rregulloren e teknikes së sigurimit për minierat dhe karierat si dhe rregulloren e teknikes së sigurimit për punët me lende plasuese në miniera.
- Të vlerësojë rehabilitimin progresiv dhe perfundimtar të mjedisit dhe të mos shkaktojë dëmtime të tij. (kushte që përfshijnë përcaktimin e variantit optimal të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit, në rastet kur projekti i zhvillimit të veprimtarive minerare jepet me disa variante, problematikat e rrezikut mineral, të sigurojë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, mjedisit, trajtimit të mbetjeve, dëmtimit të tokës, etj).
- Për kushtet gjeografike specifike në të cilën ndodhet objekt, subjekti duhet të vlerësojë sigurimin e mjeteve mbrojtëse individuale për punonjësit, sigurimin e paketës mjekësore të domosdoshme për ndihmën e parë në raste nevojë si dhe gjatë gjithë kohës duhet të mbajë në gadishmeri makine transporti në gjendje pune.
- Të respektojë rregulloren e Teknikes së Sigurimit gjatë kryerjes së punimeve me lende plasuese.
- Të respektojë distancat e rrezikshme nga puna me lende plasuese ose të marrë masat e nevojshme për parandalimin e aksidenteve dhe shmangien e rreziqeve.
- Data efektive e lejes minerare të shfrytëzimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të Qendrës Kombëtare të Licencimit.

4.2. Sigurimi Teknik

Gjatë ushtrimit të aktivitetit mineral subjekti do të mbajë parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë me të rëndësishmet dhe me të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz

Para se gjithash, ne te gjitha operacionet, do te punesohen specialiste me eksperience pune ne kryerjen e proceseve te ndryshme. .

Drejtuesi teknik i punimeve para fillimit te punes do te zbatoje rregullat dhe normat e percaktuara ne Regulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karierat te Vitit 1999 te hartuar nga Instituti i Teknologjise te miratuar me urdher te Ministrit Nr 132 date 07.04.1999 , mbeshtetur ne nenin 17 te Ligjit Minerar Shqipetar Nr 7796 date 17.02.1994.

Regulloret e Teknikes se Sigurimit te permendura me siper , nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit, dote zbatohet ne cdo proces pune, te percaktuar ne plan- organizimin e kryerj es se punimeve te hartuar nga ai dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes.

- Plan organizimi i punimeve do te hartohet para fillimit te punimeve
- Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do te beje kontrollin teknik dhe azhomirnin e sakte te punimeve te cdo lloji per te cilat subjekti ka rnarre license
- Rradha e kryerjes se punimeve do te percaktohet hollesisht ne planin e rnasave teknikoorganizative dhe do te rnratohete nga pronari i firmes
- Ne kete plan tekniko-organizativ masat e teknikes se sigurimit do te zene vendin kryesor
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruktive te rregullta rnujore e tre mujore , ku dote trajtohen lerna te vecanta per te gjitha profesionet

Rigjenerimi dhe mbrojtja e mjedisit

Ushtrimi i aktivitetit rnerar ne objektin tone eshte bere ne perputhje me Vleresimin e Ndikirnit ne Mjedis dhe masat qe duhen rnarre per ruajtjen dhe rigjenerimin e tij te parshikuar ne studimin perkates per marjen e lejes se Mjedisit nuk do te kete rigjenerim pasi punimet jane ne fazat fillestare te hapjes se punimeve

4.3. Rehabilitimi I siperfaqes qe do shfrytezohet

Veprimtaria minerare per rehabilitimin e zones se lejuar minerare te shfrytezimit gjate periudhes se lejes minerare sipas projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare te shfrytezimit do te permbaje keto operacione :

- 1,Sistemime i sheshit te depozitimit,
2. Mbushje dheu,
3. Hapje gropash,
- 4.Mbjellje Pemesh
5. Blerje e sherbime pemesh,
6. Vendosje e sinjalistikes,

4.4. Masat zbutëse ndaj ndikimeve negativë në mjedis në fazën e shfrytëzimit të objektit

Lloji i ndikimit	Masat	Komente për efikasitetin
Gërmim i shtresave të tokës	Piketim i saktë i sipërfaqes që nevojitet dhe do të shfrytëzohet	Ndikimi mbahet brenda kufijve natyralë të tij
Humbje e pjerrësisë së tokës sepse këndi i shkallëve është më i madh se pjerrësia natyrale e terrenit	Në projekt pjerrësia e skarpave të shkallëve është e madhe. Kjo pjerrësi është më e madhe se ajo natyrale e terrenit në të cilin gjendet objekti. Mbas sistemimit përfundimtar dhe mbushjes do të tentohet që ajo të ulet.	
Gjenerimi i dherave sterileve nga procesi i hapjes së shkallëve	Nuk ekzistojnë masa efektive përveç të përzgjidhet zona më e përshtatshme dhe pa patur nevojë për shumë ndërhyrje.	Masa e dheut që duhet lëvizur është tashmë e përcaktuar nga teknika e shfrytëzimit dhe nuk mund të pakësohet volumi i dherave.
Emetim zhurmash, gazesh, vibracion dhe pluhuri	Planifikim paraprak i punës dhe kohëzgjatje sa më e ulët e realizimit të shpërthimeve. Transporti i sterileve do të bëhet me kamionë të mbuluar	Do të ulet kohëzgjatja e ndikimit
Ngjeshje e pjeshme e tokës nga lëvizja e automjeteve të transportit	Lëvizje dhe parkim i kamionëve vetëm brenda zonave të caktuara	Ndikimi zbutet brenda mundësive dhe nuk shtrihet më shumë se ç'është planifikuar
Erozion në kohë me reshje	Hapje e kanalit perimetrik përgjatë transhesë kryesore të karrierës për mbledhjen e ujërave të shiut dhe drejtimi i tyre për në rezervuarin në nivelin më të poshtëm të saj. Në nivelin më të poshtëm, mund të krijohet një rezervuar i vogël që do të mbledhë ujrën e shiut me qëllim dekantimin e tyre para shkarkimit në përrua. Kanalet rrugës do të drejtohen në mënyrë të tillë që të shkarkojnë në këtë ujëmbledhës, i cili do të vazhdojë të shërbejë edhe në fazën e rehabilitimit, si burim ujor, pasi në zonë nuk evidentohen burime natyrale	Mbajtje e ndikimit brenda kufijve të origjinës
Ndotje e tokës si pasojë e avarive të mekanikës	Kontroll paraprak dhe periodik i vazhdueshëm i makinerive	Është masë e sigurt parandaluese përveç rrethanave të veçanta dhe avari të papritura
Ndikime në pejsazh, gjeologjinë dhe topografinë e zonës	Ky ndikim është i pamshëm por do të merren masa për të mbajtur ndikimin brenda sipërfaqes dhe për të ruajtur profilin gjeometrik të karrierës me qëllim që të mundësohet rehabilitimi. Duhet bërë kujdes të ruhet uniteti hapësiror i sipërfaqes dhe ndërlidhja e proceseve mjedisore dhe bashkëveprimi i elementëve midis tyre (uji, toka, bima)	
Ndikime në botën e gjallë	Puna do të jetë e organizuar me një turn, duke mënjeluar orët e papërshtatshme të punës. Mbas të bëhet inspektimi i objektit para fillimit të operacioneve dhe monitorimi i vazhdueshëm gjatë fazës së zbulimit, do të analizohet me kujdes sjellja më e mirë ndaj botës së gjallë, si p.sh. të ndërpriten punimet në faza të caktuara të ciklit vjetor të zhvillimit të biodiversitetit.	Vlerësime më të sakta për masat e duhura do të jepen në vitin e dytë mbas monitorimit të biodiversitetit në zonë gjatë vitit të parë të veprimtarisë. Një teknikë e vlerësuar efektive do të aplikohet për zvarranikët në fazën e rehabilitimit duke gdhendur faqet e skarpave të shkallëve dhe krijuar rrugë për lëvizjen normale të tyre nëpër karrierë. Këto ulluqe do të shërbejnë edhe për komunikimin e tyre dhe lëvizjen e ujërave

